



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE**
DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 374/5 prot.

Tiranë më 3.4.2019

REKOMANDIM

Nr. 25, datë 3.4.2019

PËR KONTROLLUESIN "SHKOLLA SPECIALE ZËRA JETE"

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Shkolla Speciale "Zëra Jete".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 85 datë 08.03.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit Shkolla Speciale "Zëra Jete", me objekt:

- Verifikim i ankesës së paraqitur pranë Zyrës së Komisionerit nga shtetasja S. H., në kuadër të ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave personale, në zbatim të ligjit nr. 9987/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Më datë 21.02.2019 S. H., me pozicionin e mësuesit pranë Shkollës Speciale "Zëra Jete" (shkollë e specializuar në trajtimin e fëmijëve me aftësi të veçanta), i është drejtuar Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi me ankesë, ku pretendon: "Konstatim diskriminimi dhe marrjen e masave disiplinore ndaj drejtoreshës së shkollës "Zëra Jete" dhe dënimin sipas ligjit", pasi sipas saj, në klasat ku zhvillohet mësim, janë vendosur kamera vëzhgimi.

Me shkresën 291/1 datë 27.02.2019 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i është drejtuar Zyrës së Komisionerit pasi vlerëson se pretendimet e ngritura nga ankuesi janë objekt i ligjit 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar.

Zyra e Komisionerit pasi shqyrtoi ankesën, në datën 13.03.2019 ushtroi hetim administrativ pranë kontrolluesit Shkolla Speciale "Zëra Jete".

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi, Zyra e Komisionerit konstatoi se:

1. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik, protokollin e KDIMDP-së, si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se kontrolluesi nuk ka "Njoftuar" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Njoftimi mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat kontrolluesi është përgjegjës, informon Zyrën e Komisionerit mbi kategorinë e të dhënave që përpunohen, qëllimin e përpunimit të tyre, realizimin e detyrimeve ligjore nga ana e kontrolluesit etj.

Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1, të nenit 21 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar: "Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji".

2. Kontrolluesi Shkolla Speciale "Zëra Jete" disponon një sistem video-survejimi (CCTV), i cili është i përbërë nga 15 kamera. Ambientet e mbikëqyruara janë korridore, kuzhina e gatimit, klasat e mësimit dhe ambientet e jashtme. Kontrolluesi informon subjektet e të dhënave "nëpunës", "nxënës", "vizitorë", "prindër" etj., mbi prezencën e sistemit të video-survejimit (CCTV) megjithatë, tabelat nuk janë në përputhje me formatin e miratuar sipas Udhëzimit nr. 3 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera". Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

Konstatimi sa i përket informimit jo të plotë të subjekteve të të dhënave, mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave, ushtrimin e të drejtave, të drejtën e ankimit etj., gjatë përpunimit të të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejimit (CCTV) nga kontrolluesi, përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

3. Kontrolluesi nuk ka marrë masa për hartimin e rregullave dhe udhëzimeve mbi përpunimin e të dhënave personale dhe veçanërisht për përdorimin e sistemit të video-survejimit (CCTV), në zbatim të nenit 27 të ligjit. Një element i rëndësishëm i zbatimit të këtij neni, është hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", pika 2/1: "Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregulloret e tjera".

4. Kontrolluesi disponon deklarata pëlqimi nga prindërit e fëmijëve/nxënësve mbi përdorimin e sistemit të video-survejjimit në të gjitha ambientet e shkollës si klasat ku qëndrojnë fëmijët si dhe ambiente të jashtme.
5. Kontrolluesi vendosi në dispozicion të grupit të kontrollit, petitionin me nr. 224 protokollin, datë 22.02.2019 të "Bordit të Prindërve", në lidhje me dhënien e pëlqimit të prindërve për përdorimin e sistemit të video-survejjimit si dhe marrjen e masave për funksionimin në përputhje me kuadrin ligjor të këtij sistemi, me qëllim mbrojtjen e integritetit brenda ambienteve dhe mirëqënien e fëmijëve.

Në përfundim të procesit të hetimit administrativ, grupi i kontrollit hartoi procesverbalin i cili u lexua në prani të palëve. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime dhe u shprehën se: "*Pretendimet do t'i paraqesim brenda tri ditëve në rrugë elektronike pranë K.D.I.M.D.P.*".

Më datë 15.03.2019 Shkolla Speciale "Zëra Jete" paraqiti në rrugë elektronike pretendimet duke theksuar se vendosja e kamerave është mbështetur me qëllimin e një mundësie shumë të mirë, për të monitoruar çdo veprim të nxënësve me aftësi të veçanta dhe mësuesve si më poshtë:

1. Godina ku ushtrohet procesi mësimor edukativ ndodhet në të njëjtin oborr me Kishën Ortodokse "Shën Maria" dhe për këtë arsye shkolla ka të njëjtën portë hyrëse që duhet të qëndrojë gjatë gjithë ditës hapur;
2. Shkolla s'ka roje;
3. Kontigjenti i nxënësve që frekuentojnë shkollën speciale nga viti në vit vjen dhe më i rëndë, që do të thotë se ka fëmijë me 3 diagnoza njëkohësisht;
4. Monitorimi i sjelljes së mësueses me nxënësin por edhe i sjelljes së një nxënësi të dhunshëm me një nxënë tjetër jo të dhunshëm;
5. Gjendja shëndetësore jo e mirë bën që këta nxënës të mos përcjellin tek prindërit e tyre kërkesat, ankesat apo dhe kënaqësitë;
6. Shumë fëmijë më epilepsi janë ndihmuar në monitorimin e konvulsioneve, gjë që ndihmon dhe në përcaktimin e medikamenteve të sakta nga mjeku;
7. Raste të largimit të nxënësve nga shkolla në drejtim të paditur;
8. Raste të dëmtimit të nxënësve gjatë orës së mësimi;
9. Ka raste të krizave të fëmijëve dhe prindi kërkon një informim të krizës;
10. Raste ku prindi mendon se mbi fëmijën e tij ushtrohet dhunë.

Në datën 19.03.2019, kontrolluesi Shkolla Speciale "Zëra Jete" informoi Zyrën e Komisionerit me shkresë zyrtare për masat e ndërmarra, për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara nga grupi i kontrollit:

1. Formular "Njoftimi" i plotësuar;
2. Rregullore e mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale;
3. Deklarata konfidencialiteti të stafit të Shkollës Speciale "Zëra Jete";
4. Shkresën nr. 76 prot datë 21.02.2019, drejtuar DAR-Elbasan, ku kërkohet një zgjidhje administrative për problemin;

5. Peticion i datës 22.02.2019 i prindërve të nxënësve të Shkollës Speciale “Zëra Jete”, ku shprehen dakord për vendosjen e sistemit të video-survejitimit CCTV në ambientet e shkollës;
6. Procesverbale të mbajtura me shkrim nga Bordi i Prindërve të nxënësve të Shkollës Speciale “Zëra Jete”, ku shprehen dakord për vendosjen e sistemit të video-survejitimit CCTV në ambientet e shkollës;
7. Model “*Deklarate pëlqimi*” e prindërve të nxënësve të Shkollës Speciale “Zëra Jete”, ku shprehen dakord për vendosjen e sistemit të video-survejitimit CCTV në ambientet e shkollës;
8. Model i tabelës informuese për vendosjen e sistemit të video-survejitimit CCTV, sipas standardit të miratuar nga Komisioneri;
9. Foto të vendosjes së tabelave informuese.

Sa i përket ankesës, duke marrë parasysh konstatimet dhe provat e administruara gjatë hetimit administrativ, pretendimet e kontrolluesit mbi konstatimet në përfundim të kontrollit, peticionin me nr.224 protokollit datë 22.02.2019 të “*Bordit të Prindërve*” të fëmijëve/nxënësve me aftësi të veçanta, me objekt “*Dhënien e pëlqimit të prindërve për përdorimin e sistemit të video-survejitimit si dhe marrjen e masave për funksionimin në përputhje me kuadrin ligjor të këtij sistemi, me qëllim mbrojtjen e integritetit brenda ambienteve dhe mirëqënien e fëmijëve*”, si dhe masat e marra për rikuperimin e shkeljeve të konstatuara, Zyra e Komisionerit konkludon se ankesa e paraqitur nga S. H. nuk gjen mbështetje ligjore. Vendosja e sistemit të video-survejitimit (CCTV) në ambientet e shkollës është në përputhje me një qëllim legjitim, për të cilin është marrë pëlqimi i prindërve të fëmijëve (65 pro, 2 kundër) dhe që është pranuar gjerësisht nga stafi mësimdhënës (nga 21 punonjës që ka shkolla, 3 punonjës kanë firmosur në procesverbal se janë kundër vendosjes së kamerave).

Zyra e Komisionerit vlerëson se vendosja e sistemit të video-survejitimit (CCTV) në ambientet e Shkollës Speciale “Zëra Jete” dhe qëllimi i përpunimit të të dhënave imazhe-video nëpërmjet këtij sistemi, është proporcional dhe në përputhje me parimet e nenit 5 pika 1 gërma “b”: “*në grumbullimin për qëllime specifike, të përcaktuara qartë e legjitime dhe në përpunimin në përputhje me këto qëllime*” dhe nenit 6 të ligjit, pika 1 gërma “a”: “*nëse subjekti i të dhënave personale ka dhënë pëlqimin*”.

Sa i përket verifikimit të dokumenteve të depozituara rezulton se Rregullorja dhe Formulari i Njoftimit kanë nevojë për përditësime të mëtejshme, në përputhje me veprimtarinë e kontrolluesit.

Kontrolluesi Shkolla Speciale “Zëra Jete” duhet të përmbushë detyrimet e përcaktuara në nenin 21 të ligjit nr. 9987/2008 “*Për mbrojtjen e të dhënave personale*” i ndryshuar, si përditësimi i “*Njoftimit*” (sa i përket Fushës së veprimtarisë “*edukim*”, kategoritë e subjekteve “*nëpunës, studentë, vizitorë*”, të dhënat sensitive “*shëndeti*”, qëllimi i përpunimit “*mbikëqyrje e ambientit nëpërmjet sistemit CCTV, edukim etj.*”, marrësit e të dhënave personale si “*DAR, etj.*”).

Kontrolluesi Shkolla Speciale “Zëra Jete” të hartojë rregulloren “*Për mbrojtjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale*” në përputhje me veprimtarinë e

ushtruar (pjesë e së cilës është edhe përpunimi i të dhënave nëpërmjet sistemit të video-survejitimit) në zbatim të nenit 27 të ligjit dhe Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejitimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera", si dhe çdo detyrim tjetër të përcaktuar në ligj.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 21, 27, 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1 dhe 32 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Kontrolluesi Shkolla Speciale "Zëra Jete", në zbatim të neneve 5 dhe 6 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, të ketë në vëmendje parimet e mbrojtjes së të dhënave personale dhe kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave imazhe-video, nëpërmjet sistemit të video-survejitimit (CCTV).
2. Kontrolluesi Shkolla Speciale "Zëra Jete", në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, të përditësojë pranë Zyrës së Komisionerit, "Njoftimin" mbi përpunimin e të dhënave personale për të cilat është përgjegjës, sipas pjesës arsyetuese të këtij rekomandimi.
3. Kontrolluesi Shkolla Speciale "Zëra Jete", në zbatim të nenit 27 të ligjit nr.9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, në vijimësi të ketë në vëmendje përshtatjen e rregullores për "Mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale", në përputhje me veprimtarinë e tij dhe veçanërisht, të hartojë dhe miratojë procedura të shkruara në lidhje me funksionimin e sistemit të video-survejitimit (CCTV).
4. Kontrolluesi Shkolla Speciale "Zëra Jete", të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 45 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përmbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
5. Në rast mos përmbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë, 3.4.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

